



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË**

R E L A C I O N

PËR

**PËR NIVELIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, ADMINISTRIMIN E
TYRE NË BASHKINË E KORÇËS SI DHE PENALITETET PËR SHKELJET APO
KUNDRAVAJTJET ADMINISTRATIVE PËR VITIN 2024**

Vendimi për “Nivelin e taksave dhe tarifave vendore që do të aplikohen përgjatë vitit 2024” është një nga dokumentet më thelbësore dhe më të rëndësishme të Bashkisë Korçë.

Hartimi i saj është shumë kompleks pasi në përfundim të procesit të hartimit të saj, rezultati duhet të jetë një paketë fiskale e aplikueshme dhe e integruar në të gjithë territorin e Bashkisë Korçë.

Procesi i hartimit të paketës fiskale:

- Krijimi i një grupi të përbashkët të punës për hartimin e paketës fiskale.
- Përcaktimi i bazës ligjore dhe dokumentave që do t’u referohemi.
- Vlerësimi i situatës për hartimin e propozimeve konkrete.
- Konsultim i propozimeve të paketës fiskale me përfaqësues të grupeve të interesit dhe biznesit.
- Finalizimi i procesit të hartimit të paketës fiskale dhe dërgimi për miratim pranë Këshillit Bashkiak.

Grupi i punës.

Për hartimin e paketës fiskale janë angazhuar titullarët e Bashkisë, të gjitha drejtoritë dhe ndërmarjet e varësisë.

Përcaktimi i bazës ligjore

Më poshtë në mënyrë të përmbledhur po listojmë legjislacionin fiskal vendor, i cili është konsultuar për të hartuar këtë paketë fiskale.

Ligji nr 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar

Ligji nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore” i ndryshuar

Ligji nr. 8438 datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar;

Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr.10081, datë 23.2.2009, ”Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar”;

Ligji nr. 10304, datë 15.7.2010, ”Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar;

Ligji nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar;

Ligji nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar;

Ligji nr.10465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar;

Ligji nr. 57/2020 “Për pyjet”, i ndryshuar;

Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”, i ndryshuar;

Ligji nr.10296, datë 08/07/2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar;

Ligji nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar;

Ligji nr. 152/2015, datë 21.12.2015, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”;

Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;

Ligji nr. 63/2020 “Për përmirësimin e zonave të biznesit (Bid)”

Ligji Nr. 89/2022 “Për kompetencat dhe detyrat e Policisë Bashkiake”

Ligjin nr. 50/2023 “ Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”

Vendimi i Këshillit të Ministrave, nr. 783, datë 10.11.2011, ”Për procedurat e ndarjes së të ardhurave të taksës vjetore të mjeteve të përdorura me njësitë e qeverisjes vendore”;

VKM nr.7, datë 4.01.2012, "Për përcaktimin e procedurave dhe të dokumentacionit të nevojshëm për arkëtimin e taksës së rentës minerare", i ndryshuar.

VKM nr. 970, dt 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” ;

VKM nr.1108, date 30.12.2015 “Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit rural dhe Administrimit të ujërave të Bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të Bordeve Rajonale të Kullimit”;

VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, neni 27 pika 4;

VKM nr. 132, datë 7.3.2018 “Për Metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternative të detyrimit të taksës”, i ndryshuar.

VKM nr. 475, datë 30.7.2021 “Për bashkëpunimin e njërive të vetëqeverisjes vendore me shërbimin veterinar”

VKM nr 207. Datë 15.03.2017 “Për shpalljen e qendrës historike të qytetit të Korçës dhe miratimin e rregullores për mbrojtjen, konservimin e integruar dhe administrimin e saj e të zonës së mbrojtur përreth”

Udhëzim i Ministrit të Financave nr.1, datë 12.1.2007 “Për përcaktimin e veprimtarive që trajtohen si veprimtari, tregtare apo shërbimi, ambulante si dhe procedurat e regjistrimit të tyre në organin tatimor”;

Udhëzim i Ministrit të Financave nr.32, datë 31.12.2013, "Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël", i ndryshuar.

Udhëzim i Ministrit të Financave nr.26, datë 4.09.2008, "Për taksat kombëtare", i ndryshuar.

Udhëzim i Përbashkët (Ministri i Financave dhe Ministri i Drejtësisë) nr. 655/1, datë 06.02.2007 "Për Përcaktimin e Uniformitetit të Standardeve Procedurale dhe të Raportimit të Sistemit të taksës Vendore".

Udhëzuesi i Ministrit për Çështjet Vendore nr 541/1, date 31.12.2015 "Udhëzues për zbatimin e VKM nr.1108 dat.30.12.2015 "Për transferimin nga MBZHRAU tek bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme";

Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë të Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr 12, datë 21.07.2020 " Për përcaktimin e numrit të faqeve për të cilat informacioni përfitohet falas, rastet e përjashtimit nga pagesa e tarifës, si dhe rregulla për mënyrën e kryerjes së pagesës për pajisjen me informacion që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike"

Konsultimi

Në hartimin e paketës fiskale të Bashkisë Korçë janë zhvilluar takime me grupe interesi:

1. Me banorë në qytet dhe njësi administrative
2. Me shoqatën e biznesit të vogël dhe të mesëm të Shqipërisë
3. Me përfaqësues dhe anëtarë të bordeve të zonave të biznesit BID dhe TID
4. Me përfaqësues të biznesit të vogël
5. Me përfaqësues të biznesit të madh

Çfarë synon kjo paketë fiskale:

- a) Aplikimin dhe përditësimin e bazës ligjore të ndryshuar;
- b) Përditësimin e procedurave, afateve, aktorëve, veprimeve, përgjegjësiive për vjeljen e çdo takse dhe tarife, pjesë e kësaj pakete fiskale.
- c) Përmirësimin e sistemit fiskal eficient dhe transparent;
- d) Përcaktimin e qartë në seksione të taksave dhe tarifave.
- e) Është synuar në një :
 - Taksim të drejtë
 - Tarifim të mbështetur në kosto dhe cilësi shërbimi
 - Klasifikim të biznesit sipas qarkullimit vjetor, llojit të aktivitetit, vendodhjes, etj.
- h) Aplikim të lehtësive fiskale, përjashtimeve për grupe të caktuara, kategori taksapaguesish në nevojë, e.t.j.

Referuar sa më sipër Kryetari i Bashkisë:

Propozon:

Disa shtesa, ndryshime, lehtësi, rikonceptime dhe plotësime që konsistojnë në:

- Propozim për ndryshim të nivelit të tarifës së ndriçimit.
- Propozim për ndryshim të nivelit të tarifës së gjelbërimit.
- Propozim për heqje të tarifave për lejë 24 orë
- Propozim për disa ndryshime dhe shfuqizime në masat administrative që aplikohen nga Drejtoria e Kontrollit të Territorit.
- Propozim për shtim të disa kategorive dhe miratim të niveleve në llojet dhe nivelet e gjobave që do të vendosen nga Policia Bashkiake në rastet e shkeljeve dhe kundërvajtjeve administrative
- Propozim për ndryshim të nivelit të tarifës së dhënie me qira rimorkjatori në tarifatat që aplikon Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Korçë.

Propozim për ndryshim të nivelit të tarifës së ndriçimit

Ky propozim për ndryshim të nivelit të tarifës së ndriçimit për vitin 2024 vjen i diktuar si rezultat i mosbalancës të theksuar midis të ardhurave që arkëtohen dhe kostos për ofrimin e këtij shërbimi. Në koncept tarifa është një pagesë që një individ, person fizik apo juridik bën në shkëmbim të një shërbimi specifik të marrë, të mirë publike specifike të përdorur apo të drejtë të dhënë nga njësi e vetëqeverisjes vendore. Parimi është që niveli i tarifës duhet të orientohet drejt mbulimit të kostos së shërbimit të ofruar, konsumi ose përfitimi, në parim duhet të jetë i matshëm për përdoruesin apo përfituesin, duke përdorur instrumente të përshtatshme për të siguruar aksesin, cilësinë, sasinë dhe koston e përballeshme nga të gjithë. Investimet ndër vite që Bashkia Korçë ka bërë në këtë shërbim për të cilin sot mund të themi që janë plotësuar 90% e kërkesave për shtrirjen dhe ofrimin e tij në çdo fshat të çdo njësie administrative apo çdo rrugë në qytet kanë gjeneruar një kosto vjetore që përkundrajt tarifave që aplikohen arrin të përballohet përafërsisht ½ e shpenzimeve që kryhen. Vetëm në vitet e fundit janë investuar dhe instaluar në total **1,769 ndriçuesa** të cilat kanë rritur ndjeshëm cilësinë e shërbimit por dhe sigurinë në rrugë nga të cilat konkretisht janë vendosur 1,260 shtylla të reja, janë shtrire 8,450ml kabëll nëntokësor, 28,000 ml tel alumini, 16,590 ml tubo korugato, 490 copë ndriçuesa led janë zëvendësuar në qytet, 880 ndriçuesa leq janë shtuar në njësitë administrative, 359 ndriçuesa led janë shtuar në qytetin e Korçës si dhe 40 ndriçues led janë shtuar në lulishtet e qytetit.

Duke krahasuar koston vjetore për mbulimin e shpenzimeve të shërbimit të ndriçimit e cila është në vlerën **65,558,234 lekë** dhe të ardhurat korente që planifikohen të mblidhen gjatë një viti bazuar në kapacitetet dhe nivelin e tarifës të cilat përlogariten në vlerën **33,391,800 lekë** rezulton një diferencë prej **32,166,434 lekë** ose e shprehur në përqindje me të ardhurat që planifikohen të mblidhen me nivelin aktual të tarifës mbulohet vetëm **51%** e kostos së këtij shërbimi. Pra siç shihet nga përlogaritjet jemi shumë larg balancimit dhe mbulimit të kostos së shërbimit të ndriçimit.

Referuar kostos së shërbimit, të ardhurave që parashikohen të mblidhen për mbulimin e kostove të këtij shërbimi propozojmë disa ndryshime në kategori dhe nivele:

- Tarifa e ndriçimit për kategorinë çdo familje në njësinë administrative Korçë aktualisht është **700 lekë/vit**, propozohet të bëhet **1,000 lekë/vit**. Kjo tarifë për këtë kategori do të pësojë një rritje prej **300 lekë/vit**. E shprehur në përqindje kjo kategori do të pësojë një

rritje prej **5.5%** të totalit të tarifave aktuale vjetore (5,500 lekë) Pra çdo familje do të paguajë përafërsisht **25 lekë** më shumë në pjesa e ngarkesës mujore të tarifave.

- Tarifa e ndriçimit për kategorinë çdo familje në njësitë e tjera administrative aktualisht është **500 lekë/vit**, propozohet të bëhet **700 lekë/vit**. Kjo tarifë për këtë kategori do të pësojë një rritje prej **200 lekë/vit**. E shprehur në përqindje kjo kategori do të pësojë një rritje prej **8%** të totalit të tarifave aktuale vjetore (2,500 lekë) Pra çdo familje do të paguajë përafërsisht **17 lekë** më shumë në pjesa e ngarkesës mujore të tarifave.
- Për të gjitha kategoritë e biznesit propozohet të ketë një rritje për çdo lloj fashe të biznesit të vogël apo çdo lloj kategorie të biznesit të madh. Rritja në përqindje që propozohet për biznesin e vogël në njësinë administrative Korçë sipas fashave do të variojë nga **6% - 8%** të totalit të tarifave aktuale për çdo fashë, rritja në përqindje që propozohet për biznesin e vogël në njësitë e tjera administrative sipas fashave do të variojë nga **11% - 17%** të totalit të tarifave aktuale për çdo fashë dhe rritja në përqindje që propozohet për biznesin e madh në Njësinë administrative Korçë do të variojë nga **2% - 7%** të totalit të tarifave aktuale për çdo kategori dhe në njësitë e tjera administrative rritja në përqindje që propozohet për biznesin e madh nga **4% - 8%** të totalit të tarifave aktuale për çdo kategori.

Në tabelat më poshtë po paraqesim të detajuara nr e familjeve, bizneseve sipas çdo fashe dhe kategorie si dhe efektin financiar që shoqërojnë këto propozime :

- **Tabela me numrin e familjeve që propozohen të tarifohen**

Nr	NJËSIA	NR FAMILJESH
1	Njësi administrative Korçë	15,949
2	Njësi të tjera administrative	7,147
	TOTAL	23,096

- **Efekti financiar me nivelet e propozuara për kategorinë çdo familje që propozohet të tarifohet**

	Nr Familjesh	Planifikimi / në lekë		Efekti Financiar/ në lekë
		Aktual	I propozuar	
Njësia administrative Korçë	15,949	11,164,300	15,949,000	4,784,700
Njësitë e tjera administrative	7,147	3,573,500	5,002,900	1,429,400
Totali	23,096	14,737,800	20,951,900	6,214,100

- Tabela me numrin e subjekteve të biznesit të vogël që propozohen të tarifohen

Fashat/qarkullim vjetor	Nj.Adm.Korçë
	Nr biz
0 -2	281
0-2 AMB	110
2--3	1,102
3--4	348
4--5	173
5--8	263
Totali	2,277

Fashat/qarkullim vjetor	Nj.tjera.adm
	Nr biz
0--5	277
5--8	50
Totali	327

- Tarifat aktuale dhe tarifet që propozohen për subjektet e njësisë administrative Korçë dhe njësisë të tjera administrative

Fashat/qarkullim vjetor	Tarifa e ndricimit aktuale	Tarifa e ndricimit e propozuar	Efkti financiar
ambulante	200	200	0
0-2	4,500	6,000	1,500
2-3	4,500	6,000	1,500
3-4	5,000	6,500	1,500
4-5	7,000	9,000	2,000
5-8	9,000	11,000	2,000

Fashat / qarkullim vjetor	Tarifa e ndricimit aktuale	Tarifa e ndricimit e propozuar	Efkti financiar
0-5	1,000	2,000	1,000
5-8	2,000	3,000	1,000

- Efkti financiar për subjektet e biznesit të vogël

Fashat/qarkullim vjetor	Nr biz njësia adm Korce	Vlera me tarifën aktuale	Vlera me tarifën e propozuar	Efkti financiar
-------------------------	-------------------------	--------------------------	------------------------------	-----------------

0-2	281	1,264,500	1,686,000	421,500
0-2 AMB	110	22,000	22,000	0
2--3	1,102	4,959,000	6,612,000	1,653,000
3--4	348	1,740,000	2,262,000	522,000
4--5	173	1,211,000	1,557,000	346,000
5--8	263	2,367,000	2,893,000	526,000
Totali	2,277	11,563,500	15,032,000	3,468,500
Fashat/qarkullim vjetor	Nr biz njësi të tjera administrative	Vlera me tarifën aktuale	Vlera me tarifën e propozuar	Efekti financiar
0--5	277	277,000	554,000	277,000
5--8	50	100,000	150,000	50,000
Totali	327	377,000	704,000	327,000

- **Tabela me numrin e subjekteve të biznesit të madh që propozohen të tarifohen**

LLOJI I AKTIVITETIT	Nr biz njësia Admin.Korçë
TREGTI+SHERB.	488
PRODHIM	70
HOTELE	29
NDERTIM	23
HIDROCENTRAL	3
SUPERMARKET	18
ISTIT.+ OJF	73
GURORE	1
PULARI/FRIGORIFER	3
TOTALI	708

LLOJI I AKTIVITETIT	Nr biz njësi të tjera Admin.
TREGTI+SHERB.	37
PRODHIM	17
HOTELE	2
NDERTIM	4
HIDROCENTRAL	8
SUPERMARKET	0
ISTIT.+ OJF	7
GURORE	4
PULARI/FRIGORIFER	3
TOTALI	82

- **Tarifat aktuale dhe tarifat që propozohen për subjektet e biznesit në njësinë administrative Korçë dhe njësitë e tjera administrative**

Lloj. Aktiviteti/ Njësia administrative Korçë	Tarifa e ndricimit aktuale	Tarifa e ndricimit e propozuar	Efekti financiar
---	----------------------------	--------------------------------	------------------

Lloj. Aktiviteti/ Njësitë e tjera administrative	Tarifa e ndricimit aktuale	Tarifa e ndricimit e propozuar	Efekti financiar
--	----------------------------	--------------------------------	------------------

TREGTI/SHERB.	9,000	12,000	3,000
PRODHIM	10,000	13,000	3,000
HOTEL	10,000	13,000	3,000
NDERTIM	10,000	15,000	5,000
HIDROCENTRAL	10,000	15,000	5,000
SUPERMARKET	10,000	13,000	3,000
ISTIT.+ OJF	5,000	7,500	2,500
GURORE	10,000	15,000	5,000
PULARI/FRIGORIFER	10,000	15,000	5,000

TREGTI/SHERB.	4,500	7,500	3,000
PRODHIM	5,000	8,000	3,000
HOTEL	5,000	8,000	3,000
NDERTIM	10,000	15,000	5,000
HIDROCENTRAL	10,000	15,000	5,000
SUPERMARKET	5,000	8,000	3,000
ISTIT.+ OJF	5,000	7,500	2,500
GURORE	10,000	15,000	5,000
PULARI/FRIGORIFER	10,000	15,000	5,000

○ Efekti financiar i subjekteve të biznesit të madh

LLOJI I AKTIVITETIT	Nr biz njësia Admin.Korçë	Vlera me tarifën aktuale	Vlera me tarifën e propozuar	Efekti financiar
TREGTI+SHERB.	488	4,392,000	5,856,000	1,464,000
PRODHIM / HOTELE	70	700,000	910,000	210,000
HOTELE	29	290,000	377,000	87,000
NDERTIM	23	230,000	345,000	115,000
HIDROCENTRAL	3	30,000	45,000	15,000
SUPERMARKET	18	180,000	234,000	54,000
ISTIT.+ OJF	73	365,000	547,500	182,500
GURORE	1	10,000	15,000	5,000
PULARI/FRIGORIFER	3	30,000	45,000	15,000
TOTALI	708	6,227,000	8,374,500	2,147,500

LLOJI I AKTIVITETIT	Nr biz njësi të tjera Admin.	Vlera me tarifën aktuale	Vlera me tarifën e propozuar	Efekti financiar
TREGTI+SHERB.	37	166,500	277,500	111,000
PRODHIM / HOTELE	17	85,000	136,000	51,000
HOTELE	2	10,000	16,000	6,000
NDERTIM	4	40,000	60,000	20,000
HIDROCENTRAL	8	80,000	120,000	40,000
SUPERMARKET	0	0	0	0
ISTIT.+ OJF	7	35,000	52,500	17,500
GURORE	4	40,000	60,000	20,000
PULARI/FRIGORIFER	3	30,000	45,000	15,000
TOTALI	82	486,500	767,000	280,500

Këto propozime në total gjenerojnë një efekt financiar prej 12,437,600 lekë

Të ardhurat që do të planifikohen të mblihen gjatë një viti me nivelet e propozuara bazuar në kapacitetet përlllogariten në vlerën **45,829,400 lekë** ose e shprehur në përqindje **70%** e kostos së këtij shërbimi.

Nga ky propozim për rritje nuk do preken:

- kategoria e tregëtarëve ambulantë që në total rezultojnë 110 subjekte;
- çdo familje në Njësinë Administrative Lekas
- kategoritë e familjeve kryefamiljarët e të cilave përfitojnë vetëm pension pleqërie / pension social kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë ose dhe me persona në ngarkim të tyre që janë të pa aftë për punë;

Konkretisht janë **4,361 familje** të cilat nuk do të preken nga ky propozim për ndryshim të nivelit të tarifës së ndriçimit.

Njësia	Nr Familjesh	Efekti
Njësia administrative Korçë	3,343	1,002,900
Njësitë e tjera administrative	1,018	203,600
Totali	4,361	1,206,500

Efekti financiar i kësaj mase lehtësuese për këto kategori përlllogaritet në vlerën **1,206,500 lekë**

Propozim për ndryshim të nivelit të tarifës së gjelbërimit

Edhe ky propozim për ndryshim të nivelit të tarifës së gjelbërimit për vitin 2024 diktohet si rezultat i mosbalancës midis të ardhurave që arkëtohen dhe kostos për ofrimin e këtij shërbimi. Sic dhe përmendëm më lart në koncept tarifa është një pagesë që një individ, person fizik apo juridik bën në shkëmbim të një shërbimi specifik të marrë, të mirë publike specifike të përdorur apo të drejtë të dhënë nga njësia e vetëqëverisjes vendore. Parimi është që niveli i tarifës duhet të orientohet drejt mbulimit të kostos së shërbimit të ofruar, konsumi ose përfitimi, në parim duhet të jetë i matshëm për përdoruesin apo përfituesin, duke përdorur instrumente të përshtatshme për të siguruar aksesin, cilësinë, sasinë dhe koston e përballeshme nga të gjithë.

Vetëm në vitet e fundit në territorin e Bashkisë Korçë janë shtuar **129,149 m²** sipërfaqe e gjelbër, janë mbjellë 8,559 pemë, 26,048 ligustra. Gjithashtu është investuar në pjesën e ujitjes ku vlen të përmendim që pjesa më e madhe e parqeve dhe lulishteve ujiten me ujë pusi. Janë 22 puse të hapura këto vite të cilat funksionojnë me anë të hidranteve dhe sprucatorëve që bëjnë të mundur ujitjen në formë shiu. Duke krahasuar koston vjetore për mbulimin e shpenzimeve të shërbimit të gjelbërimit e cila është në vlerën **68,371,757 lekë** ndërkohë që të ardhurat korente që planifikohen të mblihen gjatë një viti bazuar në kapacitetet dhe nivelin e tarifës përlllogariten në vlerën **21,502,000 lekë** rezultojnë një diferencë prej **46,869,757 lekë** ose e shprehur në përqindje

me të ardhurat që planifikohen të mbliidhen me nivelin aktual të tarifës mbulohet vetem **31 %** e kostos së këtij shërbimi. Pra siç shihet nga përlllogaritjet jemi shumë larg balancimit dhe mbulimit të kostos së shërbimit të gjelbërimit.

Referuar kostos së shërbimit, të ardhurave që parashikohen të mbliidhen për mbulimin e kostovete të këtij shërbimi propozojmë:

Tarifa e gjelbërimit për kategorinë çdo familje në njësinë administrative Korçë aktualisht është **500 lekë/vit**, propozohet të bëhet **700 lekë/vit**. Kjo tarifë për këtë kategori do të pësojë një rritje prej **200 lekë/vit**. E shprehur në përqindje kjo kategori do të pësojë një rritje prej **3.6%** të totalit të tarifave aktuale vjetore (5,500 lekë). Pra çdo familje do të paguajë përafërsisht **17 lekë** më shumë në pjesa e ngarkesës mujore të tarifave.

- Për të gjitha kategoritë e biznesit propozohet të ketë një rritje për çdo lloj fashe të biznesit të vogël apo çdo lloj kategorie të biznesit të madh. Rritja në përqindje që propozohet për biznesin e vogël në njësinë administrative Korçë sipas fashave do të variojë nga **6% - 8%** të totalit të tarifave aktuale për çdo fashë dhe rritja në përqindje që propozohet për biznesin e madh në njësinë administrative Korçë do të variojë nga **2% - 4%** të totalit të tarifave aktuale për kategori dhe për njësitë e tjera administrative rritja në përqindje që propozohet për biznesin e madh nga **4%- 5%** të totalit të tarifave aktuale për çdo kategori.

Në tabelat më poshtë po paraqesim të detajuara nr e familjeve, bizneseve sipas çdo fashe dhe kategorie si dhe efektin financiar që shoqërojnë këto propozime :

- **Tabela me numrin e familjeve që propozohen të tarifohen**

Nr	NJËSIA	NR FAMILJESH
1	Njësi administrative Korçë	15,949

- **Efekti financiar me nivelet e propozuara për kategorinë çdo familje që propozohet të tarifohet**

	Nr Familjesh	Planifikimi		Diferenca
		Aktual	I propozuar	
Njësia administrative Korçë	15,949	7,974,500	11,164,300	3,189,800

- **Tabela me numrin e subjekteve të biznesit të vogël që propozohen të tarifohen**

Fashat/qarkullim vjetor	Nj.Adm.Korçë Nr biz
0 -2	281
0-2 AMB	110

2--3	1,102
3--4	348
4--5	173
5--8	263
Totali	2,277

- **Tarifat aktuale dhe tarifat që propozohen për subjektet e njësisë administrative Korçë**

Fashat/qarkullim vjetor	Tarifa e gjelbërimit aktuale	Tarifa e gjelbërimit e propozuar	Efkti financiar
ambulante	100	100	0
0-2	4,000	5,500	1,500
2-3	4,000	5,500	1,500
3-4	4,500	6,000	1,500
4-5	5,000	6,500	1,500
5-8	5,000	7,000	2,000

- **Efkti financiar për subjektet e biznesit të vogël**

Fashat/qarkullim vjetor	Nr biz njësia adm Korce	Vlera me tarifën aktuale	Vlera me tarifën e propozuar	Efkti financiar
0-2	281	1,124,000	1,545,500	421,500
0-2 AMB	110	11,000	11,000	0
2--3	1,102	4,408,000	6,061,000	1,653,000
3--4	348	1,566,000	2,088,000	522,000
4--5	173	865,000	1,124,500	259,500
5--8	263	1,315,000	1,841,000	526,000
totali	2,277	9,289,000	12,671,000	3,382,000

- **Tabela me numrin e subjekteve të biznesit të madh që propozohen të tarifohen**

LLOJI I AKTIVITETIT	Nr biz njësia Admin.Korçë
TREGTI+SHERB.	488

LLOJI I AKTIVITETIT	Nr biz njësi të tjera Admin.
TREGTI+SHERB.	37

PRODHIM	70
HOTELE	29
NDERTIM	23
HIDROCENTRAL	3
SUPERMARKET	18
ISTIT.+ OJF	73
GURORE	1
PULARI/FRIGORIFER	3
TOTALI	708

PRODHIM	17
HOTELE	2
NDERTIM	4
HIDROCENTRAL	8
SUPERMARKET	0
ISTIT.+ OJF	7
GURORE	4
PULARI/FRIGORIFER	3
TOTALI	82

- **Tarifat aktuale dhe të propozuara njësia administrative Korçë dhe njësitë e tjera administrative**

Lloj. Njësia administrative Korçë	Aktiviteti/ gjobërimi aktuale	Tarifa e gjobërimin e propozuar	Efekti financiar
TREGTI+SHERB.	5,000	7,000	2,000
PRODHIM	6,000	8,000	2,000
HOTEL	10,000	12,000	2,000
NDERTIM	5,000	8,000	3,000
HIDROCENTRAL	10,000	15,000	5,000
SUPERMARKET	10,000	13,000	3,000
ISTIT.+ OJF	5,000	6,500	1,500
GURORE	10,000	15,000	5,000
PULARI/FRIGORIFER	10,000	15,000	5,000

Lloj. Njësitë e tjera administrative	Aktiviteti/ gjobërimi aktuale	Tarifa e gjobërimin e propozuar	Efekti financiar
TREGTI+SHERB.	2,500	4,500	2,000
PRODHIM	3,000	5,000	2,000
HOTEL	5,000	7,000	2,000
NDERTIM	5,000	8,000	3,000
HIDROCENTRAL	10,000	15,000	5,000
SUPERMARKET	5,000	8,000	3,000
ISTIT.+ OJF	5,000	6,500	1,500
GURORE	10,000	15,000	5,000
PULARI/FRIGORIFER	10,000	15,000	5,000

- **Efekti financiar i subjekteve të biznesit të madh**

LLOJI I AKTIVITETIT	Nr biz njësia Admin.Korçë	Vlera me tarifën aktuale	Vlera me tarifën e propozuar	Efekti financiar
TREGTI+SHERB.	488	2,440,000	3,416,000	976,000
PRODHIM	70	420,000	560,000	140,000
HOTELE	29	290,000	348,000	58,000
NDERTIM	23	115,000	184,000	69,000
HIDROCENTRAL	3	30,000	45,000	15,000
SUPERMARKET	18	180,000	234,000	54,000
ISTIT.+ OJF	73	365,000	474,500	109,500
GURORE	1	10,000	15,000	5,000
PULARI/FRIGORIFER	3	30,000	45,000	15,000
TOTALI	708	3,880,000	5,321,500	1,441,500

LLOJI I AKTIVITETIT	Nr biz njësi të tjera Admin.	Vlera me tarifën aktuale	Vlera me tarifën e propozuar	Efekti financiar
TREGTI+SHERB.	37	92,500	166,500	74,000
PRODHIM	17	51,000	85,000	34,000
HOTELE	2	10,000	14,000	4,000
NDERTIM	4	20,000	32,000	12,000
HIDROCENTRAL	8	80,000	120,000	40,000
SUPERMARKET	0	0	0	0
ISTIT.+ OJF	7	35,000	45,500	10,500
GURORE	4	40,000	60,000	20,000
PULARI/FRIGORIFER	3	30,000	45,000	15,000
TOTALI	82	358,500	568,000	209,500

Këto propozime shoqërohen me një efekt financiar prej 8,222,800 lekë.

Të ardhurat që do të planifikohen të mblihdën gjatë një viti me nivelet e propozuara bazuar në kapacitetet përlllogariten në vlerën **29,724,800** lekë ose e shprehur në përqindje **43%** e kostos së këtij shërbimi.

Nga ky propozim për rritje nuk do preken:

- kategoria e tregëtarëve ambulantë që në total rezultojnë 110 subjekte;
- kategoritë e familjeve kryefamiljarët e të cilave përfitojnë vetëm pension pleqërie / pension social kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë ose dhe me persona në ngarkim të tyre që janë të pa aftë për punë;

Këtë tarifë do vazhdojnë të mos e paguajnë familjet në njësitë e tjera administrative përveç njësisë administrative Korçë si dhe subjektet e biznesit të vogël në njësitë administrative përveç njësisë administrative Korçë.

Konkretisht janë **3,343 familje** të cilat nuk do të preken nga ky propozim për ndryshim të nivelit të tarifës së gjelbërimit.

Njësia	Nr Familjesh	Efekti
Njësia administrative Korçë	3,343	668,600
Totali	3,343	668,600

Efekti financiar i kësaj mase lehtësuese për këto kategori përlllogaritet në vlerën **668,600 lekë**

Propozim për heqje të tarifave për leje 24 orë

- Tarifë leje 24 orë për kazino të vendosura në hotele me 5 yje

Në rastin e hapjes të këtij lloj aktiviteti kompetencën për zbatim të lejes 24 ore e ka Policia e Shtetit.

- Tarifë leje 24 orë për karburant
- Tarifë leje 24 orë për Bar – Kafë, Bar – Restorant ku zhvillohen (ceremoni, pub, diskoteka dhe lokale me muzikë live) .

Propozimi për heqjen dhe mosaplikimin e këtyre tarifave për vitin 2024 vjen si lehtësi fiskale për këto kategori biznesi, ndikon në ulje të kostove të këtyre kategorive, eliminimin e procedurave në përgatitjen e praktikave të dokumentacionit dhe shkurtimin e kohës që shpenzohet për përgatitjen e procedurave për pajisje me leje.

Kjo lehtësi fiskale shoqërohet me një efekt financiar të përlogaritur në vlerën 795,000 lekë. Kjo përlogaritje është bërë bazuar në lejët e dhëna për vitin 2023 të cilat janë 28 në total.

Propozim për disa ndryshime dhe shfuqizime në masat administrative që aplikohen nga Drejtoria e Kontrollit të Territorit.

Bazuar në problematikat e hasura gjatë zbatimit të detyrave funksionale të vitit 2023, ndryshimeve ligjore të ndodhura në fund të vitit 2022 por që u implementuan në muajin Qershor 2023, konkretisht ndryshimi i ligjit nr 89/2022 “Për kompetencat dhe detyrat e Policisë Bashkiake” dhe ligjit nr 50/2023 “ Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis” propozojmë disa ndryshime në formulime, shfuqizime të disa penaliteteve të miratuara në paketën aktuale në fuqi për vitin 2023 të cilat bien ndesh dhe në kalim kompetencash referuar legjislacionit të përmendur mësipër për zbatim.

SHFUQIZIME NË LLOJET DHE NIVELET E GJOBAVE QË DO TË VENDOSEN NGA INSPEKTORËT E DREJTORISË SË KONTROLL TERRITORIT DHE DREJTORISË SË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË RASTET E SHKELJEVE DHE KUNDËRVAJTJEVE ADMINISTRATIVE

1. Niveli i gjobave për kryerjen e aktivitetit tregëtar pa liçencë, autorizim apo lejë përkatëse.

Pika c) Mospajisje me leje për tregëti ambulante, kantinë

Këtë propozim e mbështetim në ligji Nr. 89/2022 “Për kompetencat dhe detyrat e Policisë Bashkiake” neni nr.9, pika 5, gërma a. ku Policia Bashkiake si organ kompetent siguron zbatimin e akteve që përcaktojnë kryerjen e veprimtarive që trajtohen si veprimtari tregëtare apo shërbime ambulante në vende publike të përcaktuara paraprakisht nga organi i vetëqeverisjes vendore.

Zbatimi i këtij penaliteti nga Drejtoria e Kontrollit të Territorit është kalimi i kompetencave.

Pika d) Mos respektimi i sipërfaqes së lejuar për shërbim me tavolina jashtë lokalit në hapësirë publike (trotuar, sheshe e.t.j)

Këtë propozim e mbështetim në ligji Nr. 89/2022 “Për kompetencat dhe detyrat e Policisë Bashkiake” neni nr.9, pika 7, gërma a. ku Policia Bashkiake si organ kompetent në fushën e ruajtjes së hapësirës publike, Policia Bashkiake siguron zbatimin e rregullave për përdorimin e hapësirës publike, për ndalimin e zënies së hapësirave publike, hedhjen e mbeturinave dhe mbrojtjen e monumenteve, ndërtesave, parqeve dhe lulishteve publike;

Zbatimi i këtij penaliteti nga Drejtoria e Kontrollit të Territorit është kalimi i kompetencave.

Pika dh) Mospajisje me leje për ushtrim aktiviteti "24 orësh" mbas orarit të lejuar.

Këtë propozim e mbështetim në ligji Nr. 50/2023 “ Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis” neni nr.8/1:

pika 1, Policia e Shtetit është përgjegjëse për marrjen e masave për ruajtjen e qetësisë publike nga veprimtaritë që lëshojnë zhurmë nga muzika mbi nivelet e lejuara kufi nëpërmjet: a) kontrollit me pajisje të çertifikuara për matjen e niveleve të zhurmës të personave fizikë e juridikë, të cilët ushtrojnë veprimtari që lëshojnë zhurmë nga muzika; b) kontrollit, matjes, pezullimit apo mbylljes së veprimtarive, që nuk respektojnë dispozitat e këtij ligji.

pika 2. Për mjediset e hapura në zona apo qendra të banuara dhe në zonat turistike, muzika lejohet nga ora 11:00 deri në orën 24:00. Personat fizikë e juridikë respektojnë nivelin kufi të zhurmës, të përcaktuar me akt nënligjor, sipas parashikimeve të këtij ligji.

pika 3. Në rast se punonjësi i strukturës përgjegjëse të Policisë së Shtetit nuk ushtron kontroll në zbatim të pikës 1 të këtij neni, apo nuk merr masë administrative sipas parashikimeve të këtij ligji, ndaj tij merret masë sipas legjislacionit në fuqi për Policinë e Shtetit.”.

Zbatimi i këtij penaliteti nga Drejtorisë të Kontrollit të Territorit është kalimi i kompetencave.

Pika e) Mospajisje me leje për zënie të hapësirës publike veprimtarive (ekspozim malli, promocione, panaire, ekspozita dhe evente të ndryshme) të cilat do të zhvillohen në hapësirat publike

Këtë propozim e mbështetim në ligji Nr. 89/2022 “Për kompetencat dhe detyrat e Policisë Bashkiake” neni nr.9, pika 7, gërma a. ku Policia Bashkiake si organ kompetent në fushën e ruajtjes së hapësirës publike, Policia Bashkiake siguron zbatimin e rregullave për përdorimin e hapësirës publike, për ndalimin e zënies së hapësirave publike, hedhjen e mbeturinave dhe mbrojtjen e monumenteve, ndërtesave, parqeve dhe lulishteve publike;

Zbatimi i këtij penaliteti nga Drejtorisë të Kontrollit të Territorit është kalimi i kompetencave.

Pika ë) Mosrespektimi i sipërfaqes së lejuar për zënie të hapësirës publike të veprimtaritë për (ekspozim malli, promocione, panaire, ekspozita dhe evente të ndryshme) të cilat do të zhvillohen në hapësirat publike

Këtë propozim e mbështetim në ligji Nr. 89/2022 “Për kompetencat dhe detyrat e Policisë Bashkiake” neni nr.9, pika 7, gërma a. ku Policia Bashkiake si organ kompetent në fushën e ruajtjes së hapësirës publike, Policia Bashkiake siguron zbatimin e rregullave për përdorimin e hapësirës publike, për ndalimin e zënies së hapësirave publike, hedhjen e mbeturinave dhe mbrojtjen e monumenteve, ndërtesave, parqeve dhe lulishteve publike;

Zbatimi i këtij penaliteti nga Drejtorisë të Kontrollit të Territorit është kalimi i kompetencave.

Pika f) Mospajisje me leje për vendosje reklame

Këtë propozim e mbështetim në ligji nr 408, dt.13/05/2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”. Në rast konstatimi të kundërvajtjes dhe penaliteti merret nga I.M.T.V.

Zbatimi i këtij penaliteti nga Drejtorisë të Kontrollit të Territorit është kalimi i kompetencave.

Pika g) Në rastet e konstatimit të ndotjes akustike mbi nivelet e lejuara në ambjentet e brendshme dhe të jashtme të lokaleve.

Këtë propozim e mbështetim në ligji Nr. 89/2022 “Për kompetencat dhe detyrat e Policisë Bashkiake” neni nr.9, pika 4, gërma d. ku Policia Bashkiake si organ kompetent në fushën e mbrojtjes së mjedisit, verifikon dhe kontrollon zbatimin e kërkesave mbi nivelin kufi të zhurmës së lejuar nga personat fizikë e juridikë, që ushtrojnë veprimtari që gjenerojnë zhurma, në territorin e juridiksionit të tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi për zhurmat

Zbatimi i këtij penaliteti nga Drejtorisë të Kontrollit të Territorit është kalimi i kompetencave.

Pika gj) Në rastet e konstatimit të muzikës me këngëtare ose me aparatura të dixhitalizuara në individualizim të çdo subjekti që operon me aktivitet tregetar (bar – kafe, bar –

restorant e.t.j) në zonën e pazarit të vjetër, në hapësirë publike, përveç rasteve të pajisura me leje nga Bashkia

Këtë propozim e mbështetim në ligji Nr. 89/2022 “Për kompetencat dhe detyrat e Policisë Bashkiake” neni nr.9, pika 4, gërma d. ku Policia Bashkiake si organ kompetent në fushën e mbrojtjes së mjedisit, verifikon dhe kontrollon zbatimin e kërkesave mbi nivelin kufi të zhurmës së lejuar nga personat fizikë e juridikë, që ushtrojnë veprimtari që gjenerojnë zhurma, në territorin e juridiksionit të tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi për zhurmat. Ligjin nr. 50/2023 “ Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis” neni nr.8/1: **pika 1**, Policia e Shtetit është përgjegjëse për marrjen e masave për ruajtjen e qetësisë publike nga veprimtaritë që lëshojnë zhurmë nga muzika mbi nivelet e lejuara kufi nëpërmjet: a) kontrollit me pajisje të certifikuara për matjen e niveleve të zhurmës të personave fizikë e juridikë, të cilët ushtrojnë veprimtari që lëshojnë zhurmë nga muzika; b) kontrollit, matjes, pezullimit apo mbylljes së veprimtarive, që nuk respektojnë dispozitat e këtij ligji.

Zbatimi i këtij penaliteti nga Drejtorisë të Kontrollit të Territorit është kalimi i kompetencave.

2. Niveli i gjobave për dëmtim dhe ndërhyrje në infrastrukturën rrugore pa lejë të posaçme.

Pika c) Bllokim rruge, korsi biçikletash dhe hapësira të tjera publike në të (me inerte, materiale të ngurta, mjete promociionale, konë parkimi, sende të tjera)

Këtë propozim e mbështetim në ligji Nr. 89/2022 “Për kompetencat dhe detyrat e Policisë Bashkiake” neni nr.9, pika 7, gërma a. ku Policia Bashkiake si organ kompetent në fushën e ruajtjes së hapësirës publike siguron zbatimin e rregullave për përdorimin e hapësirës publike, për ndalimin e zënies së hapësirave publike, hedhjen e mbeturinave dhe mbrojtjen e monumenteve, ndërtesave, parqeve dhe lulishteve publike;

Zbatimi i këtij penaliteti nga Drejtorisë të Kontrollit të Territorit është kalimi i kompetencave.

Pika e) Bllokim trotuari, korsi biçikletash hapësira të tjera publike në të (me inerte, materiale të ngurta, mjete promociionale, vazo lulesh, pedana e.t.j)

Këtë propozim e mbështetim në ligji Nr. 89/2022 “Për kompetencat dhe detyrat e Policisë Bashkiake” neni nr.9, pika 7, gërma a. ku Policia Bashkiake si organ kompetent në fushën e ruajtjes së hapësirës publike siguron zbatimin e rregullave për përdorimin e hapësirës publike, për ndalimin e zënies së hapësirave publike, hedhjen e mbeturinave dhe mbrojtjen e monumenteve, ndërtesave, parqeve dhe lulishteve publike;

Zbatimi i këtij penaliteti nga Drejtorisë të Kontrollit të Territorit është kalimi i kompetencave.

3. Niveli i gjobave për dëmtimet dhe ndërhyrjet në rrjetin e shpërndarjes dhe ndriçimit rrugor pa lejë të posaçme.

Pika a) Lidhje ose mirëmbajtje e pamiruar në rrjetin ajror (fibra optike, kablo shpërndaesë e.t.j)

Këtë propozim e mbështetim në ligjin për A.K.E.P icili është organi kompetent për instalimin, miratimin, kontrollin e rrjeteve ajrore të fibrave dhe kablove të internetit.

Zbatimi i këtij penaliteti nga Drejtorisë të Kontrollit të Territorit është kalimi i kompetencave.

4. Niveli i gjobave për dëmtime dhe ndërhyrje në rrjetin e ujësjellësit.

Pika a) Lidhje e pa miruar në tubacion

Pika c) Dëmtimi i tubacioneve nga punimet që kryhen pranë tyre me leje ose pa leje

Këto propozime i mbështetim me arsyetimin se në të gjitha rastet e konstatuara organi kompetent për miratimin e ndërhyrjeve dhe marrjen e masave është SH.R.U.K.KO

Zbatimi i këtyre penaliteteve nga Drejtorisë të Kontrollit të Territorit është kalimi i kompetencave.

5. Niveli i gjobave për ndërhyrje dhe dëmtime në hapësirat e gjelbëra dhe publike.

Pika a) Dëmtim i hapësirave publike të gjelbërta

Pika b) Dëmtim, prerje, krasitje e pemëve dhe grumbullimi i frutit ose lules në përdorim farmaceutik

Pika c) Zënie e hapësirës të gjelbër (tavolina, promocione e.t.j)

Pika d) Vendosje tabelash, pankartash, banderolash, posterash, njoftimesh në pemet dekorative
Këto propozime i mbështetim në ligji Nr. 89/2022 “Për kompetencat dhe detyrat e Policisë Bashkiake” neni nr.9, pika 7, gërma a. ku Policia Bashkiake si organ kompetent në fushën e ruajtjes së hapësirës publike siguron zbatimin e rregullave për përdorimin e hapësirës publike, për ndalimin e zënies së hapësirave publike, hedhjen e mbeturinave dhe mbrojtjen e monumenteve, ndërtesave, parqeve dhe lulishteve publike;

Zbatimi i këtyre penaliteteve nga Drejtoria e Kontrollit të Territorit është kalimi i kompetencave.

8. Niveli i gjobave për mosrespektim të kushteve dhe detyrimeve kontraktuale në shërbimin e transportit publik qytetës (urban).

Propozimi për shfuqizimin e këtij niveli së bashku me penalitetet bazohet në struktura organike Drejtorisë së Menaxhimit të Kontratave dhe Shërbimeve dhe në kontrata e shërbimit të transportit për udhëtarët në linjat qytetëse të Bashkisë Korçë me Nr.4334/5 prot, datë 19/06/2023 me arsyetimin si mëposhtë:

Në struktura organike e Drejtorisë së Menaxhimit të Kontratave dhe Shërbimeve funksionon sektori i menaxhimit të kontratave dhe shërbimeve i cili ka për detyrë funksionale zbatimin rigoroz të kontratës së shërbimit nr.4334/5 prot, datë 19/06/2023 dhe penalitet e përfshira të parashikuara në nenin 23 për penalitetet e kontratës si dhe neni 28 për të gjitha nënpikat e përshkruara në kontratë, ku qartëson mënyrën e veprimeve dhe mos veprimeve të personave përgjegjës për zbatimin e penaliteteve nga Drejtoria e Menaxhimit të Kontratave dhe Shërbimeve.

Zbatimi i këtyre penaliteteve nga Drejtoria e Kontrollit të Territorit është kalimi i kompetencave.

SAKTËSIME DHE PLOTËSIME NË LLOJET DHE NIVELET E GJOBAVE QË DO TË VENDOSEN NGA INSPEKTORËT E DREJTORISË SË KONTROLL TERRITORIT DHE DREJTORISË SË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË RASTET E SHKELJEVE DHE KUNDËRVAJTJEVE ADMINISTRATIVE

1. Niveli i gjobave për kryerjen e aktivitetit tregëtar pa licencë, autorizim apo lejë përkatëse.

a Mospajisja me licensë, autorizim apo certifikatë përkatëse transporti :

Aktualisht është

- Në transportin e udhëtarëve me taksi
Propozohet të plotësohet
- Në transportin e udhëtarëve me taksi (subjekt i regjistruar në organet tatimore)

Aktualisht është

- Në transportin e udhëtarëve me autobus:
Propozohet të plotësohet

- Në transportin e udhëtarëve me autobus në linjat që liçensohen nga Bashkia (subjekt i regjistruar në organet tatimore)

Aktualisht është

- Mos respektimi i kushteve të operimit të përcaktuara në liçencë për linjat e transportit të udhëtarëve, lidhur me itinerarin, oraret, vendqëndrimet dhe frekuencën e linjës përkatëse. Propozohet të plotësohet
- Mos respektimi i kushteve të operimit të përcaktuara në liçencë për linjat e transportit të udhëtarëve që liçensohen nga Bashkia Korçë, lidhur me itinerarin, oraret, vendqëndrimet dhe frekuencën e linjës përkatëse.

Aktualisht është

- Në transportin e mallrave: Propozohet të plotësohet
- Në transportin e mallrave: (subjekt i regjistruar në organet tatimore)

6. Niveli i gjobave për dëmtimet dhe ndërhyrjet në rrjetin e shpërndarjes dhe ndriçimit rrugor pa lejë të posaçme.

Aktualisht është

ç. Përdorimi i shtyllave të rrjetit shpërndarës apo ndriçimit rrugor si suport për montimin e reklamave, kapjen e kabllave etj.

Propozohet të plotësohet

ç. Përdorimi i shtyllave të ndriçimit rrugor si suport për montimin e reklamave, kapjen e kabllave etj.

Aktualisht është

dh. Dëmtim i traseve, kabllave dhe linjave ajrore nga punimet që kryhen pranë tyre me leje dhe pa leje si dhe shkulja e shtyllave.

Propozohet të plotësohet

dh. Dëmtim i traseve, kabllave dhe linjave nëntokësore nga punimet që kryhen pranë tyre me leje dhe pa leje si dhe shkulja e shtyllave.

SHTIMI I NJË KATEGORIE DHE NIVELI NË LLOJET DHE NIVELET E GJOBAVE QË DO TË VENDOSEN NGA INSPEKTORËT E DREJTORISË SË KONTROLL TERRITORIT DHE DREJTORISË SË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË RASTET E SHKELJEVE DHE KUNDËRVAJTJEVE ADMINISTRATIVE

1. Niveli i gjobave për kryerjen e aktivitetit tregëtar pa liçencë, autorizim apo lejë përkatëse.

Në zbatim të detyrave funksionale dhe verifikimeve në terren gjatë vitit 2023 janë konstatuar subjekte me aktivitet tregëtar taksi (4+1) por dhe raste të tjera të cilat kryejnë aplikimin për kalim në status pasiv në Q.K.B por që vazhdojnë të ushtrojnë aktivitetin e tyre. Për minimizimin e këtyre situatave propozojmë miratimin e një penaltetit të ri. Nëse subjektet dhe mbas penalizimit me kundërvajtje administrative do të vazhdojnë të zhvillojnë aktivitetin e tyre do ndërmeren masat shtërguese deri në anulimin e liçencës.

Propozohet:

- Kur subjekti taksi ka kryer pezullim aktiviteti dhe konstatohet në mënyrë të përsëritur vazhdimi i ushtrimit të aktivitetit taksi.

Në lidhje me masën e kundërvajtjes administrative të propozuar më sipër propozojmë vlerën **10,000 lekë**.

Propozim për shtim të disa kategorive dhe miratim të niveleve në llojet dhe nivelet e gjobave që do të vendosen nga Policia Bashkiake në rastet e shkeljeve dhe kundërvajtjeve administrative

Bazuar në ndryshimet ligjore të ndodhura në fund të vitit 2022 por që u implementuan në muajin Qershor 2023 , konkretisht ndryshimi i ligjit nr 89/2022 “Për kompetencat dhe detyrat e Policisë Bashkiake” dhe ligjit nr 50/2023 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis” propozojmë që kategoritë dhe nivelet e kundërvajtjeve administrative të cilat ishin në tejkallim kompetencë nga Drejtoria e Kontrollit të Territorit të zbatohen nga struktura e Policisë Bashkiake me disa ndryshime në formulime.

Propozojmë kategoritë dhe nivelet si më poshtë:

1. Niveli i gjobave për kryerjen e aktivitetit tregëtar pa licencë, autorizim apo lejë përkatëse.	
a. Mospajisje me leje për tregëti ambulante, kantinë	1,000 deri 5,000 lekë
b. Mos respektimi i sipërfaqes së lejuar për shërbim me tavolina jashtë lokalit në hapësirë publike (trotuar, sheshe e.t.j)	10,000 lekë
c. Mospajisje me leje për zënie të hapësirës publike <ul style="list-style-type: none"> veprimtarive (ekspozim malli, promociione, panaire, ekspozita dhe evente të ndryshme) të cilat do të zhvillohen në hapësirat publike 	10,000 lekë
ç. Mosrespektimi i sipërfaqes së lejuar për zënie të hapësirës publike <ul style="list-style-type: none"> veprimtarive (ekspozim malli, promociione, panaire, ekspozita dhe evente të ndryshme) të cilat do të zhvillohen në hapësirat publike 	5,000 lekë
d. Në rastet e konstatimit të ndotjes akustike mbi nivelet e lejuara në ambjentet e brendshme dhe të jashtme të lokaleve.	20 000 lekë
dh. Në rastet e konstatimit të muzikës me këngëtare ose me aparatura të dixhitalizuara në individualizim të çdo subjekti që operon me aktivitet tregëtar (bar – kafe, bar – restorant e.t.j) në zonën e pazarit të vjetër, në hapësirë publike, përveç rasteve të pajisura me leje nga Bashkia	20,000 lekë
2. Niveli i gjobave për dëmtim dhe ndërhyrje në infrastrukturën rrugore pa lejë të posaçme.	
a. Bllokim rruge, korsi biçikletash dhe hapësira të tjera publike në të (me inerte, materiale të ngurta, mjete promociionale, konë parkimi, sende të tjera)	10,000 deri 20,000 lekë
b. Bllokim trotuari, korsi biçikletash hapësira të tjera publike në të (me inerte, materiale të ngurta, mjete promociionale, vazo lulesh, pedana e.t.j)	5,000 deri 20,000 lekë
3. Niveli i gjobave për ndërhyrje dhe dëmtime në hapësirat e gjelbëra dhe publike.	
a. Dëmtim i hapësirave publike të gjelbërta	10,000 deri 20,000 lekë

b. Dëmtim, prerje, krasitje e pemëve dhe grumbullimi i frutit ose lules në përdorim farmaceutik	10,000 deri 20,000 lekë
c. Zënie e hapësirës të gjelbër (tavolina, promocione e.t.j)	20,000 lekë
d. Vendosje tabelash, pankartash, banderolash, posterash, njoftimesh në pemet dekorative të Bashkisë Korçë	10,000 lekë

Propozim për ndryshim të nivelit të tarifës së dhënie me qira rimorkjatori në tarifatat që aplikon Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Korçë.

Në lidhje me këtë propozim është marrë në konsideratë norma e harxhimit të karburantit (41 l/100km), norma e amortizimit (përdorimit) si dhe koha e transportimit. Aktualisht tarifa që aplikohet për dhënie me qira rimorkiatori është 12lekë/t/km

Duke marrë në konsideratë faktorët e përmendur më sipër propozojmë që kjo tarifa të ketë 2 nivele tarifimi bazuar në distancat që do përdoret.

- Për distanca më të largëta se 100 km tarifa do të përllogaritet: 12 lekë x ngarkesën maksimale të transportimit x kilometrat e transportimit. (12 lekë x 33T x km) Pra tarifa për distanca më të largëta se 100 km do të jetë 396 lekë për 1km
- Për distanca më të vogla se 100 km tarifa do të përllogaritet: 15 lekë x ngarkesën maksimale të transportimit x kilometrat e transportimit. (15 lekë x 33T x km) Pra tarifa për distanca më të vogla se 100 km do të jetë 495 lekë për 1km

Gjatë vitit 2023 nuk ka pasur asnjë rast për dhënie me qira rimorkiatori pasi kostot për kryerjen e këtij shërbimi rezultuan më të larta sesa vlera e tarifës që do arkëtohej për këtë shërbim.

Ndryshimet, rikonceptimet, riformulimet, plotësimet, shtesat, lehtësitë apo dhe përjashtimet synojnë të mbrojnë interesat e të gjithë aktorëve të përfshirë në zbatimin e paketës fiskale, për ta kuptuar drejt dhe për të shmangur paqartësitë, duke lehtësuar zgjidhjen e konflikteve që mund të lindin.

Drejtoria e Përgjithshme Juridike

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore

dhe Burimeve Njerëzore

Anxhela Dishnica

Soniel Prifti

Për Drejtorinë e Kontrollit Teritorial

Drejtoria e Përgjithshme e Financës, Buxhetit

Lorenc Palodhi

dhe M.F.K

Valbona Ziko

Për Policinë Bashkiake

Për Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike

Erald Kreka

Ilirjan Dinellari

KRYETARI I BASHKISË

SOTIRAQ FILO